

Pyetjet e shpeshta – Sesioni Q&A për sub-grante

Përshtatshmëria

1. Kush ka të drejtë të aplikojë për këtë subvencion?

Entitetet e pranueshme për mbështetje financiare në kuadër të kësaj thirrjeje janë organizatat vendase jofitimprurëse dhe joqeveritare të shoqërisë civile (OJQ) të regjistruara në Kosovë.

2. A mund të aplikojnë individët, apo vetëm organizatat?

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për t'u kualifikuar për një grant: Të jenë subjekt juridik i regjistruar të paktën tre (3) vjet para datës së shpalljes së kësaj thirrjeje dhe të jenë të regjistruar në Kosovë.

3. A kanë të drejtë të aplikojnë grupet joformale ose të paregjistruara?

Jo, grupet joformale apo të paregjistruara nuk janë të pranueshme për të aplikuar, vetëm OJQ-të e regjistruara mund të aplikojnë.

4. A lejohet financimi i palëve të treta?

Dhënia e subgranteve për palë të treta nuk lejohet, përveç nëse të gjitha kostot e lidhura mbulohen plotësisht nga vetë organizata që zbaton projektin.

5. Si ndahet buxheti i projektit midis aktiviteteve dhe personelit/shpenzimeve të tjera?

Aplikuesit kërkohen që të ndajnë të paktën 60% të buxhetit të propozuar për aktivitetet e drejtpërdrejta të projektit, duke përfshirë zbatimin e projektit, organizimin e ngjarjeve, materialet, udhëtimet dhe shpenzime të tjera të lidhura me aktivitetet. Deri në 40% të buxhetit total mund të ndahet për shpenzimet për burime njerëzore (si pagat dhe mëditjet) dhe shpenzimet administrative, të cilat janë të domosdoshme për menaxhimin dhe administrimin efektiv të projektit.

Procesi i aplikimit

6. Cili është afati i fundit për aplikim?

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve: 16 korrik 2025, ora 23:59, sipas kohës lokale në Kosovë.



7. Ku dhe si duhet të dorëzojmë aplikimin?

Aplikimi mund të dorëzohet në formë elektronike në info@kdi-kosova.org.

8. A mund ta dorëzojmë aplikimin në gjuhët zyrtare (shqip/serbisht)?

Po, mund ta dorëzoni aplikimin në gjuhën shqipe ose serbe.

9. A ka ndonjë format apo shabllon të detyrueshëm?

Formati i kërkuar gjendet në thirrjen për aplikime.

10. A mund të dorëzojmë më shumë se një propozim?

Jo, një organizatë mund të dorëzojë vetëm një propozim.

11. A kërkohet bashkëfinancim për zbatimin e kësaj aktiviteti?

Bashkëfinancimi nuk kërkohet për zbatimin e këtij aktiviteti.

12. A mund të aplikoj nëse organizata është themeluar vitin e kaluar?

Jo fatkeqësisht, organizatat që janë themeluar më pak se tre vjet më parë nuk janë të pranueshme për të aplikuar.

13. A mund të përdoret ky projekt si bashkëfinancim i një projekti tjetër?

Jo, ky projekt nuk mund të përdoret si bashkëfinancim për ndonjë projekt tjetër.

14. A lejohet që një organizatë e grave apo e të rinjve (që nuk e ka luftën kundër korrupsionit në statut) të aplikojë?

Po, një organizatë e grave apo e të rinjve mund të aplikojë edhe nëse lufta kundër korrupsionit nuk është në statut, për sa kohë projekti përputhet me objektivat/qëllimet e thirrjes.

15. A jemi të liruar nga TVSH-ja gjatë zbatimit të këtij projekti?

Po, jeni të liruar nga TVSH gjatë zbatimit të këtij projekti, siç është përcaktuar në thirrjen për aplikime.